

AKT THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

CARTOTECNICA TOSCANA

Me ane te ketij dokumenti sot me daten 15/11/2021

z.Fatmir Taraj, me numer personal G20225107R, i lindur ne Durres me date 25/02/1962, qytetar shqiptar, titullar i leternjoftimit nr.036226632;

z.Agim Taraj, me numer personal G61209027U, i lindur ne Durres, me date 09/12/1966, qytetar shqiptar, titullar i leternjoftimit nr.032512090;

vendosin per sa me poshte vijon :

1. Te themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar te emertuar **CARTOTECNICA TOSCANA**.

2. Shoqeria **CARTOTECNICA TOSCANA** eshte nje person juridik i te drejtes shqiptare qe operon si e tille nga dita e regjistrimit ne regjistrin tregetar prane Qendres Kombetare te Biznesit. Aktiviteti i saj do te rregullohet konform dispozitave te ketij Statuti, te Aktit te Themelimit bashkangjitur dhe te legjislacionit shqiptar ne fuqi. Kohezgjatja e aktivitetit vendoset te jete **e pacaktuar**, por kjo mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se pergjithshme.

3. Shoqeria ka per objekt te aktivitetit te saj : Prodhimi i çantave me materiale te ndryshme, leter, karton, tekstil etj, per llogari te saj apo per te trete.

Ndertime me nje ose shume kate, civile ose industriale, impiante elektrike, rrjete hidrike, kanalizime dhe vepra te tjera urbane.

4. Selia e shoqerise vendoset te jete ne Lushnjë, Lagja Kadri Qystri , Rruga "Bajram Xhafa"Nr.49, Zona Kadastrale Nr.8571, Nr.pasurie 6/11.



5. Kapitali shoqeror fillestar eshte ne vleren 3.000.000 leke(tremilione),i perbere nga dy kuota si me poshte:

- Nje kuote,ne masen 51% te kapitalit fillestar me vlere 1.530.000 leke ne zoterim te z.Fatmir Taraj,
- Nje kuote,ne masen 49% te kapitalit fillestar me vlere 1.470.000 leke ne zoterim te z.Agim Taraj.

6.Administrimi dhe perfaqesimi i shoqerise i besohet nje Administratori te Vetem, qe mund edhe mos te jete ortak.Administratori emerohetme Vendim te Asamblese se Pergjithshme, per nje afat maksimal 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje dhe rri ne detyre derikur jep doreheqjen ose shkarkohet nga Asamblea e Pergjithshme.

Me vendim unanim te Asamblese,per administrimin e aktivitetit te shoqerise emerohet Administrator i Vetem

zj.Ermira Beu,me numer personal H46205089J,lindur me date 05/12/1974, qytetare shqiptare, titullare e leternjoftimit nr.036222614,te cilesi jepet e drejta e firmes dhe e perfaqesimit ligjor te shoqerise ne perputhje me ligjin nr.9901 dt.14.04.2008"Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare"neni 95.

7. Viti ekonomik ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti.

Viti i pare ushtrimor mbyllet me date 31 Dhjetor 2021.

8.Ne perfundim te vitit ushtrimor, pas aprovimit te pasqyrave financiare, Asamblea vendos destinacionin e fitimit neto vjetor. Ky fitim mund te transferohet lirisht jashte Shqiperise konform legjislacionit ne fuqi. Per humbjet pergjigjet ekskluzivisht shoqeria me kapitalin e saj.

9.Ortaket dhe administratoret jane te detyruar ligjerisht te ruajne konfidencialitetin mbi



dokumentacionin, te dhenat, njohurite dhe eksperiencat e fituara gjate aktivitetit te shoqerise, si dhe te marrin te gjitha masat e nevojshme te sigurise per te evituar perhapjen, qofte edhe pjesore, te tyre.

Ata jane pergjegjes per pasoja te mundshme negative qe i vijne shoqerise nga shkelja nga ana e tyre e detyrimeve te sa me siper thene.

10. Persa nuk specifikohe shprehimisht ne kete akt, vlejne normat e Statutit bashkangjitur dhe te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

ORTAKET

Fatmir Taraj

Fatmir Taraj
[Signature]

Agim Taraj

Agim Taraj
[Signature]